



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.14/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi kryesues, Hidajete Gashi Alaj, dhe Skender Çoçaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga [REDAKTUAR], votuese me vendbanim në Gjermani, parashtruar kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, lidhur me mos regjistrimin në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosove, për Zgjedhjet për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 03.01.2025, mori këtë :

V E N D I M

KONSIDEROHET e tërhequr ankesa Anr.14/2024 e datës 31.12.2024, e parashtruar nga [REDAKTUAR], parashtruar kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shkak të mos regjistrimit si votuese jashtë Kosove për Zgjedhje për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 09 shkurt 2025.

Arsyetim

Me datën 31.12.2024, PZAP-i ka pranuar përmes emailit zyrtar ankesë nga ankuesja [REDAKTUAR], me vendbanim në Gjermani, parashtruar kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosove, për Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës, që do të mbahen me datë 09 Shkurt 2025.

Ankuesja ka theksuar se i posedon të gjitha dokumentet e nevojshme, dhe të vlefshme që kërkohen për regjistrimin. Për këtë arsye, nuk e konsideron refuzimin e aplikimit të saj si të drejtë.

Bazuar në nenin 10.5 dhe 98 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, PZAP-i ka kërkuar nga pala ankuese që për parashtrimin e ankesës e njejta ti përmbahet kushteve siç parashihen me dispozitat ligjore për tu parashtruar një ankesë, dhe bazuar në nenin 11 paragrafi 9 i Rregullorës së PZAP-it 01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosies së Ankesave, duke i dhënë afat për plotësimin e kërkesës deri me datë 02.01.2025 në ora 12:00, dhe e ka njoftuar palën ankuese se ankesa do të konsiderohet e tërhequr, ndërsa nëse e njejta kthehet si e paplotësuar, do të hedhet poshtë.

Në nenin 10.4. të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës në mënyrë decisive thuhet se *“Personi që ka aplikuar për t’u regjistruar si votues jashtë Kosovës, mund të parashtrorë ankesë në PZAP, përmes postës ose sistemit elektronik, për mospërfshirjen e tij në Listën e votuesve, brenda afatit prej dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i njoftimit nga KQZ-ja”*.

Në nenin 10.5. të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës në mënyrë decisive thuhet se: *“Ankesa e personit jashtë Kosovës që dorëzohet në PZAP në mënyrë elektronike, duhet të jetë e nënshkruar, e skanuar dhe duhet t’i këtë të bashkangjitura dokumentet valide të lëshuara nga organet kompetente të Republikës së Kosovës, të cilat identifikojnë ankuesin. Ankesa e tillë, dërgohet vetëm nga email - adresa personale e ankuesit”.*

Ndërsa në nenin 11 paragrafi 9 të Rregullorës së PZAP-it 01/2024 Për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosi së Ankesave në mënyrë decisive thuhet se: *“Ankesa që nuk i plotëson kriteret sipas nenit 5 të kësaj rregullore i kthehet personit ankues në plotësim dhe permisim në afat të caktuar nga Paneli deri në njëzet e katër (24) orë. Ankesa do të konsiderohet e tërhequr nëse nuk i kthehet përgjigje PZAP-it në afatin e dhënë, e në qoftë se kthehet e pa plotësuar do të hedhet poshtë”.*

Me qenëse pala ankuese nuk ju ka përmbajtur kërkesës së PZAP-it për plotësimin e ankesës, dhe nuk ka plotësuar ankesën e saj, Paneli bazuar në nenin 10.5 dhe 98 të LZP-së, si dhe nenin 11 paragrafi 9 i Rregulloreë së PZAP-it 01/2024 ankesën e parashtruesit e konsideroi të tërhequr.

Prandaj PZAP-i, mbi këtë bazë dhe nga arsyet e lartpërmendura, dhe në kuptim të dispozitës së nenit 10.5, 98.3 dhe nenit 119.3 të LZP-së, si dhe nenit 11 paragrafi 9 i Rregulloreë së PZAP-it 01/2024 vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
A.nr.14/2024 datë: 03.01.2025

Kryesues i Panelit,
Bujar Muzaqi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.